



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo-Komuna e Mitrovicës
 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË

DATË/A:	24.12.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Zyra e Informimit Znj. Blerina Kastrati
CC:	Kabineti i Kryetarit z.Agim Bahtiri
NGA/OD/FROM:	z.Naser Muja Drejtori i Drejtorisë Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PLANIFIKIMI PËR VITIN 2019

MITROVICË

Drejtori DSHPI-Naser Muja



Fjala e Drejtorit

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë (DSHPI) e konsideron publikimin e planifikimin më shume se sa permbushje të një detyrimi ligjor dhe institucional. Në vazhdim do t'ju paraqesim planifikimin e punës së Drejtorisë që udhëheqi respektivisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës , i cili është një konsiderim real i punës sonë gjatë një viti plot ritëm dhe bashkëveprim në mënyren profesionale.

Viti 2018, do të jetë një vit i punës me një vullum dhe ritëm të madh si në sektorin e Infrastrukturës ashtu edhe në Shërbimet Publike. Vizioni i përcaktuar në dokumentin strategjik të prioriteteve dhe objektivave të Komunës së Mitrovicës dhe nevojat në territorin e Komunës, na dhanë shtysën kryesore për të punuar më shumë në aspektin ligjore, organizative dhe profesional të punëve.Kemi planifikim për rritjen e stafit profesional në aspektin inxhiniering dhe rritjen e cilësisë së punës.

Ne sigurisht që do të bëjmë përpjekje maksimale për marrjen e fondeve nga Ministritë e ndryshme për rregullimin e infrastrukturës, të cilat do të jenë të mirseardhura.

Naser Muja

**PLANIFIKIMI I DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË****Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë REALIZIMI I PRIORITETEVE, INFRASTRUKTURA RRUGORE.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës ka ushtruar veprimtarinë konform detyrimeve dhe përgjegjësiqe që përcakton Statuti Komunal në realizimin e projekteve në disa rrafshet komplekse dhe shumëdimensionale, me theks të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, duke intervenuar optimalisht konform pozicioneve të përcaktuara sipas buxhetit komunal. Hartimi i planeve e projekteve konkrete afatshkurtra dhe afatmesme duke përpiluar edhe Rregullore dhe Vendime adekuate të kësaj natyre, duke ofruar shërbime efektive dhe profesionale gjithnjë në të mirë të Komunës dhe qytetarëve të sajë ka qenë dhe mbetet objektiv parësor. Prioritetet e përcaktuara nga kjo drejtori për vitin 2018 janë:

- Ndërtimi i rrugëve lokale e regionale
- Ndërtimi i rrugëve lokale me kubëza betoni me participim me qytetarët
- Ndriçimi publik
- Shenjëzimi horizontal, vertikal e sinjalizues Autoparkingjet
- Ndërtimi i trotuareve, Shesheve dhe hapësirave të ngjashme
- Dhënia e hapësirave publike me qira apo me koncesion
- Licencimi i auto-taxive të qytetit
- Shërbime profesionale, inspektime, mbikëqyrje, pranime teknike,
- Aktvendime, procedura kundërvajtës, procesverbale etj.
- Zbatimi dhe monitorimi i projekteve të ndryshme ndërtimore në lëmin e infrastrukturës ;
- Zbatimi dhe monitorimi i projekteve të ndryshme të angazhuara nga drejtorit tjera në nivel Komunal
- Përgatitja e lëndëve të drejtorive përkatëse në të cilat ka nevojë për inxhinieri ndërtimore;
- Pjesëmarrja në hapjen e tenderëve si dhe klasifikimin e ofertuesëve;
- Planifikimi i buxhetit 2018-2020 dhe përgatitja e projektpropozimeve të ndryshme
- Krijimi-ndërtimi i hapësirave të reja të gjelbërta

Raporti është pregaditur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe infrastruktures dhe perbledhe situaten për realizimin e projekteve infrastrukturore si dhe shërbimet e realizura, ky raport paraqet situaten e realizimit te investimeve te vitit 2018

**MISIONI I DSHPI-së**

1. Zbatimin e ligjshmërisë i cili në vete ngërthen;

a) vetë qëndrueshmërinë financiarisht të ofruesve të shërbimeve të dy sektorëve,

b) zbatimin e kritereve ekonomike në rastet e proceseve rregullatore.

PËRGJEGJËSIT E DSHPI-së

Përgjegjësia e DSHPI-së është shumë komplekse e cila kërkon staf të mjaftueshëm, experiencë të duhur në fushë veprimin e angazhuar dhe më gjerë, mirë të kualifikuar i cili në rastin tonë mund të thuhet se nuk ka qenë i mjaftueshëm gjatë vitit 2018.


Edhe përkundër asaj që u theksua i njëjti ka qenë dhe është shumë i përkushtuar për zbatim të ligjit, politikave dhe të proceseve të cilat duhet të zhvillohen, të cilat janë kompensuar me një organizim të mirë, përgatitje të duhur, ekzekutim dhe monitorim të gjitha fazave dhe etapave nëpër të cilën duhej kaluar për ti përmbush detyrat e punës. Këtë e ka mundur në radhë të parë komunikimi i rregullt i brendshëm dhe i ndërsjellë me të gjitha palët e interesit, duke pas si cak një monitorim të duhur, vlerësim të mirë të dhënave të mbledhura, duke krahasuar të njëjtat me objektivat kohore të caktuara.

Nuk është e tepërt të thuhet se stafin e këtij departamenti duhet ta karakterizojnë njohurit shumë dimensionale e specifike, të cilat janë mase të domosdoshme, për përmbylljen me sukses të proceseve të përcaktuara nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon DSHPI.

ORGANIZIMI I DSHPI-së

Publike dhe Infrastrukturë, aktivitetet i filloi duke u bazuar në program të punës, në buxhetin komunal dhe objektivat e qeverisë komunale për vitin 2019, si dhe vazhdimin e punëve të planifikuara nga viti i kaluar.

DSHPI përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Shërbimeve Publike dhe Sektori i Infrastrukturës.



**Prioritetet kryesore të drejtorisë për vitin 2019:*****Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në qytete dhe në fshatra***

-asfaltimi i rrugëve,-kubëzimi i rrugëve,-ndërtimi i trotuareve-riparimi i rrugëve dhe -ndërtimi i rrugëve me zhavor.

Përmirsimi i gjendjes së furnizimit me ujë të qytetarëve dhe gjendja e kanalizimeve

-ndërtimi i sistemeve dhe rrjeteve të reja të ujësjellësve,-ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza dhe-riparimi i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike dhe fekale.

Përmirsimi i fondit të sipërfaqeve të gjelbruara

-ndërtimi i shesheve,-ndërtimi i parqeve,-ngritja e sipërfaqeve të reja të gjelbruara.

Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit public

-Përmirsimi i gjendjes së sinjalizimit, rregullimi i trafikut dhe transporti public,-Përmirsimi i shërbimeve komunale,-mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve,-mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara,

-mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik,-mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo-Komuna e Mitrovicës
 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë



Projektet

Vlera

Planifikimi i Prokurimit

Vazhdimi me Zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriqimit publike
Hartimi i projekteve për investime kapitale
Shenjzimi i rrugëve
Ndërtimi, furnizimi dhe deblokimi rrjetit të kanalizimit
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsëve, statcionit të pompimit, furnizim me material për ujësjellës, rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësve
Ndërtimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve me kubeza
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kqiq
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Pirq
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Koshtovë
Asfaltimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vaganicë
Ndërtimi i rrugëve në Stan Tërg
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vinarc
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bare
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Rahovë
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Tërstenë
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Suhodoll
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Lushtë
Ndërtimi i rrugëve në Tunel të parë
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mazhiq
Ndërtimi i rrugëve Melenicë-Maxhere-Dedi
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Bajgore
Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vllahi
Ndërtimi dhe mirëmbajtja e parqeve në Hapsira Publike
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Frashër
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Vidimriq
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Fushë Ibër
Ndërtimi i rrugës në fshatin Shupkovc



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo-Komuna e Mitrovicës
Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë



Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Vërrnicë

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërrnushë

Furnizimi, vendosja dhe mirëmbajtja e semaforëve

Vazhdimi i ndërtimit të Parkut Botanik bashkëfinancim me MMPH

Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Preten-Stan Tërg bashkëfinancim me MAPL

Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Stan Tërg bashkëfinancim me MI

Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Kovaçic bashkëfinancim me MI

Vazhdimin e procedurave për kontratën për ndërtimin e Lumit Ibër dhe Lumit Sitnica

Fshirja dhe Larja e rrugëve

Thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë